

RELACION I PROJEKTIT

PËRSHKRIMI HISTORIK I QYTETIT

Vau i Dejës ka të bëjë me qytetin tashmë të zhdukur të Dejës.

Deja (ose Danja) ka qenë qytet mesjetar shqiptar shumë i rëndësishëm me një histori vërtet interesante, i themeluar rreth vitit 1127. Ekzistenca e trojeve te vjetra te keshtjelles dhe kishes se Shen Markut, e cila eshte nder me te vjetrat ne Ballkan, ende sot mbartin vlera arkeologjike per studimet historike. Qyteti u ndërtua në shek.XI-XII në pikën ku del Drini nga malësitë. Zotëronte rrugën e karvanëve dhe vilte të ardhura të shumta nga doganat që paguheshin për kalimin e Vaut të Dejës. Sipas historianeve ne kete zone organizohej cdo vit një panair i madh ne te cilin merrnin pjese baore nga krahina e Zadrimes. Nga fillimi i shekullit XIII qëndroi nën sundimin e feudalëve serbë. Këtu u fuqizua familja feudale e Zahariajve. Me formimin e principatës së Balshajve, Deja u bë pjesë e saj. Më 1396, Gjergji II Balsha ia kaloi qytetin Venedikut. Në vitet 1423-1443, Deja kaloi dy herë në dorë të osmanëve për tu çliruar në 1443 pas kryengritjes së përgjithshme antiosmane. Zotërimi i Dejës u bë shkak konflikti midis feudalëve N.Dukagjini dhe L.Zaharia në 1445. Pas vrasjes së këtij të fundit, qyteti iu ridorëzua nga e ëma e tij, Venedikut. Ishte pikërisht kërkesa e Skënderbeut që Venediku t'i dorëzonte Dejën që shkaktoi luftën mes tij dhe Venedikut. Skënderbeu e rrethoi në 1447-1448, por nuk e mori dot. Qyteti qëndroi nën Venedikun deri në 1479, kur e ripushtuan osmanët. Pas kësaj, ai nuk u rimëkëmb më. Sot mund të shihet ende Kalaja e Dejës, brenda së cilës janë gërmadhat e një kishe.





QYTETI VAU DEJES

Te dhena per qytetin Vau Dejës:

- Është pjesë e Qarkut/Rrethit Shkodër
- Sipërfaqja totale 499.09 km²
- Popullsia (Census viti 2011) 30,438 banorë
Sipas regjistrat civil 48,966 banorë

Zona Gjeografike:

Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës.

Territori i bashkise shtrihet pjeserisht ne zone kodrinore malore ne Lindje dhe pjeserisht ne zonen perëndimore fushore. Nje pjese e territorit te bashkise perbehet nga liqeni i Hidrocentralit te Vaut te Dejes. Pjesa me e zhvilluar urbane eshte perqendruar pergjate zones fushore ne perëndim.

Per shkak te pozicionit gjeografik te Bashkise si dhe kalimi i rruges kombetare Shkoder Puke mespermes territorit te saj ka ndikuar ne nje konfiguracion urban te veçante.



Popullsia:

Sipas Censusit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30,438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë

aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Profili i Bashkisë

Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 komuna, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit.

Komuna e Bushatit, e cila i shtohet Bashkisë së re është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunat Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbytur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës.

Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë.

E veçantë për këtë bashki është ekzistanca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmbytjet.

Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vaut të Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat ende sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vaut të Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau i Dejës deri në Koman.

Territori i Bashkisë është i pasur me monumente historike të cilat mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Ndër to përmëndim: Kalaja e Danjës, Kalaja e

Shurdhahut, Kalaja e Qytezës, Kalaja e Dalmacisë. Gjithashtu, ndodhen një sërë kishash të vjetra dhe objektesh fetare me shumë interes për t'u vizituar si: Katedralja e Shën Gjergj Sapës, e Nënë Terezës, kisha e Shën Markut, e Shën Marisë, e Shën Kollit, e Shën Rrokut, apo xhamia e Bushatit, Kosmacit, Melgushës etj.

Zona është e njojur për figurat e shumta historike që kanë lënë gjurmë të paharrueshme në kujtesën historike të shqiptarëve të tillë si Lek Zaharia, Frang Bardhi, At Shtjefën Gjecovi, Dom Ndre Mjeda e shumë të tjera. Pejsazhet panoramike të tilla si kodrat dhe malet me një bukuri natyrore të veçantë, shëtitjet me varka në ligen apo plazhet buzë ligenit, fshatrat e vendosura në kodrat e bukura dhe të buta të zonës, ushqimet lokale bio dhe gatimet tradicionale e kthejnë Vaun e Dejës në një territor të përshtatshëm për agroturizëm. Bashkia paraqet një zonë të pasur etnografike. Etnografia e Zadrimës, Mirditës, Malësisë së Madhe dhe pjesa e qytetit janë pjesë e mozaikut të pasur të trashëgimisë kulturore, historike dhe shpirtërore të bashkisë.

Qellimi i projektit

Bashkia Vau Dejes, me buxhetin e vitit 2016 dhe ne vazhdim ka planifikuar te financoje projektin "Rikualifikim i Qendres se Qytetit" Faza 1, Bashkia Vau Dejes. Keto punime jane parashikuar ne qendren e qytetit Vau Dejes, duke qene tashme qendra e Bashkise Vau Dejes dhe qender funksionale per levizjet e perditshme te banoreve nga te gjitha zonat (sic pershkruhet me lart) si dhe per terheqjen e rritjen e numrit te turisteve ne qendren e qytetit te vjeter te Danjes (Deja).

Kjo zone ka qene pjesë e etapave te rendesishme historike dhe sot kjo hapsire nuk ploteson aspak kushtet e te qenit qender e Bashkise Vau Dejes si pasardhese e nje zone historike me rendesi.

Hapsira e sheshit te ndertimit

Gjendja aktuale

Hapsira e qendres se qytetit Vau Dejes eshte aktualisht nga nje shkalle e larte herogjeniteti ne shtrim, bimesi, materiale etj.

Verehet nje perzierje e hapsirave per automjete dhe atyre pedonale, nje shperndarje e çrregullt e hapsirave te destinuara per parkim apo ambjente çlodhje e gjelberimi. Verehen gjithashtu edhe pika te degradimit dhe konsiderohen e domosdoshme nderyria per menaxhimin e hapsires duke siguruar ketu edhe ndriçimin e plote te gjithe hapsires si dhe shtrimin e korsive per bicikleta e per kembesore.



Qendra ekzistuese e qytetit



Sistemi rrugor ne bashkine Vau Dejes

Pershkrimi i projektit

Ne kete projekt jane pasqyruar dhe reflektuar punime te shtresave rrugore dhe me trotuare per kembesore dhe korsi per bicikleta duke ruajtuar uniformitetin dhe ne pershtatje te arkitektures dhe te krijimit te kushteve sa me afer qytezes historike.

- Redaktimi i nje projekti qe te nxjerre ne pah dinjitetin e qytetit dhe te zones.
- I integruar mes hapsirave dhe godinave ekzistuese te jashtme.
- Riorganizimi funksional dhe hapsinore.
- Futja e hapsirave te reja te sherbimit dhe hapsirave fleksibel.
- Rritje e shfrytezimit te hapsires dhe perfitimeve nga ajo.

Segmenti i prekur nga ky projekt ka nje gjatesi prej 360 ml ne pjesen qendrore te qytetit te Vau Dejesit. Kjo gjatesi eshte paraqitur ne projektin e miratuar, ne Aksin nr.1, ne segmentin B-C. Shetitorja do te kete gjeresi te pergjithshme 17.0ml. pjesa e rruges do te kete gjeresi 8.0ml dhe ne ted y anete kuneta te cila mbledhun ujrat me gjeresi $2 \times 0.5\text{ml}$.

Korsite e bicikletave jane 1.0 dhe 2.0m, si dhe trotuaret $2 \times 2.0\text{m}$ be ted y anet. Punimet kryesore te specifikuara ne projekt dhe te dhena edhe ne preventivin e objektit jane te ndara ne disa kapituj siç jane:

- Punime germimi dhe prishje.
- Punime ne rruge.
- Punime ne trotuare.
- Punime ne KUB + KUZ.
- Punime per ndriçimin rrugor + linaj rezerve.

- Punime sinjalistike.
- Punime gjelberimi.


Punimet kryesore te parashikuara jane ato te shtresave perjate rruges ne qendren e qytetit Vau Dejes. Shtresat rrugore jane si me poshte:

- Shtrese me pllaka guri 10cm
- Shtrese llac cimento 5cm
- Shtrese b/a +zgara hekuri 15cm
- Shtrese stabilizanti 15cm
- Shtrese cakulli 20cm
- Shtrese gjeofilter 0.8cm

Shtresat e trotuareve dhe korsise se bicikletave jane si me poshte:

- Shtrese me pllaka guri 8cm
- Shtrese llac cimento 5cm
- Shtrese b/a +zgara hekuri 10cm
- Shtrese zhavori 25cm
- Shtrese gjeofilter 0.8cm





Profil i terthor tip.

- Siperfaqja e shtresave ne rruge eshte 3995 m^2 ku jana parashikuar qe pas punime te prishjes dhe heqjes se shtresave ekzistuese te realizohen shtresat me cakell, shtrese betoni me zgare hekuri si dhe shtrim me pllaka guri i cili do te jete si me poshte:

Per rrugen: Shtrese me pllaka guri standarte, te punuara ne menyre dekorative $t= 10\text{cm}$, me cepa te thyer e vendosur mbi llaç M-25, $t= 5\text{cm}$, me fuga $1.0 \sim 1.5 \text{ cm}$ te punuar ne menyre dekorative me bojak çimentoje (rere finoje/çimento).

Per trotuarin: Pllaka guri, te standartizuara $t= 8 \text{ cm}$, te fiksuar me llaç çimento M-25 te punuar me fuga me llaç çimento, me siperfaqe 2060m^2 .

Gjithashtu si nenshtrese eshte parashikuar edhe shtresa me gjeotekstil pas ndertimit te kasonetes ne toke dhe cilindrimit te saj me rru.

Ne projekt jane parashikuar sistemime te shtresave te asfaltit ne disa zona te

vogla ku ka probleme emergjente.

Projekti ka te parashikuar nderhyrjen ne sistemin ekanalizimeve KUB + KUZ per gjate gjatesise se zones ku do te behet nderhyrja, ku jane parashikuar shtrim i tubave HDPE nga 250 mm ne 400 mm, tub betoni 1000mm si dhe hapja e pusetave te shiut dhe atyre te kontrollit te shperndara sipas percaktimeve ne projekt.

Punimet per ndriçimin e hapsires perfshijne zevendesimin e disa shtyllave metalike dhe ndriçuesave ekzistues, me shtylla te reja dhe me ndriçues LED 30W, 220v IP 65 duke siguruar keshtu nje ndriçim me te mire dhe me konsum minimal te energjise elektrike. Per linjen e re te ndriçimit dhe nje pjese te asaj ekzistuese eshte parashikuar vendosja e nje transformatori fuqie prej 100KVA se bashku me shtyllat centrifugale dhe konstrukjonet perkatese.

E gjithe hapsira do te plotesohet me sinjalistikes e duhur sipas percaktimeve dhe nevoja te pershtatura.

Gjelberimi ze nje pjese te rendesishme te ketij projekte duke krijuar nje ambjent rekreativ te pershtatshmen per levizjen e kembesoreve, te ciklisteve apo dhe per ambjente pushimi, me bar, lule dhe peme dekorative, stola etj.

“GOLD CONSTRUCTION”SHPK
ARK.DIANA PROGR

